



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-351/02-140224
Dt. 23.10.2025
P r i z r e n

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e **Zijadin Sinanaj** nga fsh.Shkoze posedues individual **Pasuri Shoqerore O.P.E.e Pylltarise Sharri Prishtine** me Kontrate per qirane e tokes Pyjore me Ref: DE-343/24 te dt.12.03.2024 dhe Pelqim me nr.Ref:De-342/24 te dt.12.03.2024 në bazë të nenit 3 alineja 1pika 7 e lidhur me nenin 17 dhe 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-212 dt. 31.07.2013, si dhe nenit 3 alineja 1pika1.1,1.4,1.7,1.10,1.17,1.20,1.21 dhe te nenit 5alineja1pika 1.1si dhe nenit 14 alineja 1pika 1.1 dhe ne lidhje me nenin 15 alineja 1 pika1.2 dhe nenit 19 alineja 2 të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe dhe sipas vendimit per miratimin e HZK per peridhen 2022-2030 Nr.001-011-48192 te dt 31.03.2022, si dhe nenit 85 te LVL dhe te nenit 27,44,46,47,48 si dhe te nenit 125 te LPPA nr.05/031 dt.25.05.2016 si dhe konform nenit14,15,16,17 dhe 18 te Udhezimit Administrativ nr.06.2017 dt.23.05.2017 si dhe konform nenit 4 pika6.1,paragrafi 2dhe paragrafi 14 si dhe konform nenit 34 e Rregullores për taksa Komunale nr.001/011-99275 dt.30.06.2022 dhe Vendimit per percaktimin e Takses administrative per leshimin e lejes ndertimore dhe tarifa per rregullimin e infrastruktures ne teritorin e qytetit te prizrenit nr.01/011-41141 te dt.10.04.2014 merr kete:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Zijadin Sinanaj nga fsh.Shkoze posedues individual Pasuri Shoqerore O.P.E.e Pylltarise Sharri Prishtine		
Adresa:	Fsh.Vermice		
Telefoni:	//	Emaili:	//

Emri i projektit	Objekti –Shtalle e dhive		
Emri i projektuesit	Byroja projektuese “INGconcept ”SH.P.K.		
Adresa:	Luan Haradinaj-Decan pn.		
Telefoni:	//	Emaili:	//

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore Zijadin Sinanaj nga **fsh.Shkoze** posedues individual **Pasuri Shoqerore O.P.E.e Pylltarise Sharri Prishtine** i lejohet ndërtimi i objektit –me konstrukcione metalike e baze betoni shtalle e dhive shtalle per dhi ne fsh. Vermice me etazhitet **P+0** në ngastrën katastrale numër **P-718130008-02634-0 Z.K.Vermice**.

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	fshVermice	
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Vermice e në ZB Objekti për: Shtalle e dhive do të ndërtohet ne "fsh Vermice" me etazhitet P+0 në ngastrën katastrale numër P-718130008-02634-0 Z.K.Vermice, sip.totalë sipas listës poseduese 7002729m² e ndërtimi bëhet në sip.2680m² të skicës së gjeodetit (me Kontrate për qira të tokës pyjore) Etazhiteti i objektit do të jetë P+0 Sipërfaqja bruto e përdhësës është S=375.m² (sipas lejes dhe për pagesë). Sipërfaqja neto është S=344.0m² sipas lejes Sipërfaqja bruto e objektit është S=375.0m²(sipas lejes) Është miratuar taksa administrative për leshimin e lejes ndërtimore në shumën prej 1571.25€ Parallogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej 122,898.90€.	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtimi i ri ☒	Rindërtim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☐	Kategoria II ☒
A përfshin kërkesa ndryshimin e destinimit? Po ☐ Jo ☒	
Përdorimi i propozuar i objektit – shtalle e dhive	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Zijadin Sinanaj nga **fsh.Shkoze** posedues individual **Pasuri Shoqerore O.P.E.e Pylltarise Sharri Prishtine** i lejohet ndërtimi i objektit –me konstrukcione metalike e baze betoni shtalle e dhive shtalle per dhi ne fsh. Vermice me etazhitet **P+0**

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
 - Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
 - Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Në kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuar nga Drejtoria e Inspektionit – inspektorati i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga koprojektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rast kur:
- Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;

- Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.
 - Kunjëzimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas kushteve ndërtimore si dhe dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori.
- P.S. Investitori është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte dhe është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK, KEDS-it, dhe avari tjera ti evitojë dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.

A r s y e t i m

Aplikuesit **Zijadin Sinanaj** nga fsh. Shkoze posedues individual **Pasuri Shogerore O.P.E.e Pylltarise Sharri Prishtine** i lejohet ndërtimi i objektit –me konstrukcione metalike e baze betoni shtalle e dhive **shtalle per dhi** ne fsh Vermice me etazhitet **P+0**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësim të dokumentacionit
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”(te respektohet pëlqimi me kushte te cilat i kane shenuar ne kete pëlqim) .
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Pëlqimi nga “Ekoregjion”.
- Pëlqim nga Drejtora e Shërbimeve publike-Spektori i komunikacionit
- Leja Mjedisore Komunale.
- Pëlqimi nga KRU Dukagjini-Radoniqi”Sh.A. Gjakove
- Fletëpagesa e taksave për rregullimin e tokës ndërtimore
- Kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet MMPHI-së , brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-140224

Bashkëpunëtor profesional:

Zana Belloda, inxhi. dip. ark.

Drejtori:

Pranverim Berisha, jur.